



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 455/ 5 prot

Datë 25.02.2025

V E N D I M
Nr. 280/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.02.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Anullimin e shortit të datës 10.02.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-26458-10-25-2024, me objekt “Supervizion punimesh per objektin “Ndertim i sistemit te Kanalizimeve Njesise Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec” me fond limit: 8.028.361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles Kanalizime sha Rajoni Pogradec.

Autoriteti Kontraktor: Ujesjelles Kanalizime sha Rajoni Pogradec.
Adresë: Rruga e Gurasit , Guras Pogradec.

Ankimues: Operatori ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK me NIPT L91810005U, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Pallati Nr. 45, Shkalla Nr. 01, Kt Nr. 1, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: Bashkimi operatorëve ekonomikë “HTS Company” SHPK & “HE & SK 11” SHPK me NIPT M11619018P dhe NIPT L19008502B, me Adresa: Rruga “Komuna e Parisit”, Zona Kadastrale 8260, Numri i pasurise 6/278/ND+1-18, Hyrja 1, Apartamenti 20, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I****Vlerësimi Paraprak**

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 28.10.2024 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-26458-10-25-2024, me objekt “Supervizion punimesh për objektin “Ndertim i sistemit të Kanalizimeve Njesise Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec” me fond limit: 8.028.361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH,

parashikuar për t'u zhvilluar më datë 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles Kanalizime sha Rajoni Pogradec.

II.2. Në datën 07.11.2024 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 16.12.2024 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. BOE "Transport Highway Consulting" SHPK & "Elite Studio" SHPK & "Civil Cons" SHPK | 7.024.816,38 I kualifikuar |
| 2. BOE "HTS Company" shpk & "HE & SK 11" shpk | 7.024.816,39 I kualifikuar |
| 3. BOE "Zetakonsult" SHPK & "Zenit & Co" SHPK | 7.024.816,39 I kualifikuar |
| 4. B.O.E "Hydro-Eng Consulting" SHPK & "P.C.S Company" SHPK | 7.024.816,39 I kualifikuar |
| 5. "Gjeokonsult & Co" SHPK | 7.024.816,39 I kualifikuar |

II.4. Në datën 27.12.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE "*Formular Njoftim - Fituesi Paraprak*", për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 90, datë 30.12.2024,, ku është shpallur fitues BOE "*Transport Highway Consulting*" shpk & "*Elite Studio*" SHPK & "*Civil Cons*" SHPK.

II.5. Në datën 01.01.2025, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2024/4948 dhe me nr. 02/2025 prot, datë 06.01.2025, e operatorit ekonomik "*Gjeokonsult & Co*" SHPK për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*" me Nr. REF-26458-10-25-2024, me objekt "*Supervizion punimesh per objektin "Ndertim i sistemit te Kanalizimeve Njesise Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec"*" me fond limit: 8.028.361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles Kanalizime sha Rajoni Pogradec. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues "*Transport Highway Consulting*" SHPK & "*Elite Studio*" SHPK & "*Civil Cons*" SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna

të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 02/1 prot., datë 06.01.2025 janë publikuar pretendimet që operatori ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK, ka parashtruar në formular ankesë.

II.7. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA, ka dërguar shkresën përcjellëse me nr. 13/3 prot., datë 13.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 02/2 prot., datë 13.01.2025 me objekt “Vendim për shqyrtim ankesë” dërguar me sistem elektronik, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA, ka dërguar shkresën përcjellëse me nr. 52 prot., datë 15.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 02/3 prot., datë 17.01.2025 me objekt “Vendim për shqyrtim ankesë” dërguar me sistem elektronik, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

II.10. Në datë 24.01.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 128/2025, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga OE ankimues “Gjeokonsult & Co” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime”, me Nr. REF-26458-10-25-2024 me objekt “Supervizim punimesh për objektin: Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njësisë administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, me fond limit 8 028 361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec.*
2. *Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim, duke skualifikuar operatorin ekonomik “Transport Highway Consulting” SHPK.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga OE ankimues “Gjeokonsult & Co” SHPK”.*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.11. Me shkresën nr. 13/6 prot., datë 28.01.2025, protokolluar me tonën nr. 02/8 prot., datë 03.02.2025, autoriteti kontraktor njofton se, ka zbatuar vendimin Nr. 128/2025, datë 24.01.2025. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 128/2025, datë 24.01.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin, në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) të ofertave, referuar konstatimeve, në zbatim të vendimit të KPP Nr. Nr. 128/2025, datë 24.01.2025. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke skualifikuar operatorin ekonomik “*Transport Highway Consulting*” SHPK, në zbatim të konstatimeve të shprehura në vendimin KPP Nr. 128/2025, datë 24.01.2025.

II.12. Në datë 04.02.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 172/2025, ku vendosi:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime”, me Nr. REF-26458-10-25-2024 me objekt “Supervizim punimesh për objektin: Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njesisë administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, me fond limit 8 028 361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetëlës Kanalizime Pogradec.*

2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.13. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike konkretisht rubrikës kërkesa për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi rezulton se autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik të kualifikuar me vlerë ofertë të barabartë si më poshtë vijon:

Shoqëria Rajonale Ujësjetëlës Kanalizime sha Pogradec , mbështetur ne VKM nr 285/2021 “Per miratimin e rregullave per prokurimin publik” neni 82 pika 6 per proceduren e prokurimit me objekt “Supervizion punimesh per objektin “Ndertimi i sistemit te kanalizimeve te njesise administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, Procedure e hapur e thjeshtuar – sherbime, me fondi limit 8.028.361,587 (tetë million e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH vendosi te perzgjedhe fituesin e procedures nepermjet procesit te hedhjes se shortit , per aresye se operatoret ekonomike pjesemares kane ofertuar me vlere te njejte.

Shorti do te zhvillohet prane zyrave qendrore te Shoqerise Rajonale Ujësjetëlës Kanalizime Pogradec , me adrese “Rruga e Gurrasit “Bucimas Pogradec, ne date 10.02.2025 ora 11:00.

II.14. Në datën 10.02.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar shortin, pjesëmarrës në shortë kanë qënë operatorët ekonomikë si vijon:

- | | |
|---|----------------------------|
| 1. BOE "HTS Company" shpk & "HE & SK 11" shpk | 7.024.816,39 I kualifikuar |
| 2. BOE "Zetakonsult" SHPK & "Zenit & Co" SHPK | 7.024.816,39 I kualifikuar |
| 3. "Gjeokonsult & Co" SHPK | 7.024.816,39 I kualifikuar |

II.15. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se fitues nga shorti i datës 10.02.2025, rezulton bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE "HTS Company" SHPK & "HE & SK 11" SHPK.

II.16. Në datën 18.02.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE "Formular Njoftim - Fituesi Paraprak", për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ku është shpallur fitues BOE "HTS Company" SHPK & "HE & SK 11" SHPK.

II.17. Në datën 17.02.2025, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2024/5054 dhe me nr. 455/2025 prot, datë 17.02.2025, e operatorit ekonomik "Gjeokonsult & CO" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar" me Nr. REF-26458-10-25-2024, me objekt "Supervizion punimesh per objektin "Ndertim i sistemit te Kanalizimeve Njesise Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec" me fond limit: 8.028.361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles Kanalizime sha Rajoni Pogradec. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me hedhjen e shortit të datës 10.02.2025 me pretendimet si vijon:

Për këtë procedurë, jemi njoftuar më datë 07.02.2025 në SPE se, do të vijohej me hedhjen e shortit për këtë procedurë, short i cili do të zhvillohej më datë 10.02.2025 mes operatorëve ekonomikë me arsyetimin se operatorët kanë ofertuar me vlerë të njëjtë.

Më datë 10.02.2025, nga ana e OE "Gjeokonsult & Co" sh.p.k., është paraqitur përpara Autoritetit Kontraktor, kërkesa me Nr. 26 Prot., e protokolluar nga AK me Nr. 125 Prot., datë 10.02.2025, me objekt "shpalljen e Gjeokonsult & Co" sh.p.k., si operatorin e vetëm fitues, pa zhvillimin e shortit me operatorët e tjerë ekonomikë, për objektin "procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime", me Nr. REF-26458-10-25-2024 me objekt "supervizim punimesh për objektin: ndërtim i sistemit të kanalizimeve të njësisë administrative Udenisht, Bashkia Pogradecë.

Nga ana e KVO-së nuk u mor parasysh kjo kërkesë duke u vijuar me hedhjen e shortit i cili për mënyrën dhe procedurën e mbajtjes së tij gjithashtu është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Kjo kërkesë adminsitruar pranë AK, ka parashtruar faktin se pranë Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 01.01.2025 është paraqitur ankesa me Nr. 02/2025 protokolli, me datë 06.01.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/4948 e operatorit ekonomik "Gjeokonsult & Co" sh.p.k., ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të

vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Transport Highway Consulting” sh.p.k.

Në vendimin Nr. 02/6 Prot., të datës 24.01.2025, Vendim Nr. 128/2025, Komisioni i Prokurimit Publik ka cilësuar se gjatë shqyrtimit të akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

Nëpërmjet këtij vendimi KPP-ja, ka vendosur të pranojë ankesën e paraqitur nga OE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. ? Si dhe të skualifikojë operatorin ekonomik të shpallur fitues “Transport Highway Consulting” sh.p.k.

Si rrjedhojë e skualifikimi të OE “Transport Highway Consulting” sh.p.k., jemi njoftuar se më datë 10.02.2025, do të hidhet shorti mes operatorëve ekonomikë; B.O.E “HTS Company” sh.p.k. & “HE & SK 11” sh.p.k 7.024.816,39; B.O.E “Zetakonsult” shpk & “Zenit & Co” sh.p.k 7.024.816,39; B.O.E “Hydro-Eng Consulting” sh.p.k & “P.C.S Company” shpk 7.024.816,39; “Gjeokonsult & Co” sh.p.k 7.024.816,39.

Pjesëmarrja edhe e operatorëve të tjerë ekonomikë në përzgjedhjen e shpalljes së fituesit gjatë hedhjes së shortit është i padrejtë pasi me vendimin e tij KPP-ja nuk ka bërë pranim pjesor të ankesës së OE igjeokonsult&coë sh.p.k., por e ka pranuar plotësisht atë me të gjitha kërkesat e bëra.

Në nenin Neni 114, “trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor”, 3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës;c) refuzimin e ankesës.

Në rastin Konkret Autoriteti Kontraktor ka vendosur të pranojë ankesën e Operatorit Ekonomik “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. Ky vendim i KPP-së i cili përcakton se pranon ankesën e Operatorit Ekonomik është detyrues për Autoritetin i cili nuk duhet të devijojë nga përmbajtja e tij duke i dhënë vendimit kuptim të zgjeruar. Me pranimin e ankesës nëpërmjet këtij vendimi KPP-ja ka pranuar ankesë e bëra nga OE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k., ku ndër kërkesat e bëra ishte kërkitimi i shpalljes fitues i OE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k., kërkitim për të cilin KPP-ja nuk ka shprehur refuzim.

Duke qenë se operatorët e tjerë ekonomikë nuk kanë paraqitur ankesë, ata nuk kanë ushtruar të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin dhe nuk mund të përfitojnë nga përpjekjet e “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. Shkak i ngritjes së këtij ankimi është procedura E HEDHJES SË shortit nga ana e AK, pasi e procedura e shortuar lë vend për dyshime mbi përzgjedhjen dhe paracaktimin e fituesit për shkak të mbajtjes së saj.

Shorti i mbajtur më datë 10.02.2025, pranë AK është një short në shkelje të rregullave të prokurimit publik pasi; Nga ana e AK është vendosur që zgjedhja të bëhet nga operatorët sipas renditjes së gjeneruar në Sistemin e SPE të Autoritetit, ndërkohë kjo nuk është e drejtë. Pse duhet të përzgjidhet kjo renditje kur në renditjen e konsatatur në SPE-në e Operatorit Ekonomik “Gjeokonsult & Co” sh.p.k., kjo renditje rezulton e ndryshme nga ajo e paraqitur nga AK. Nga ana e Autoritetit, nuk është zbatuar një procedurë hedhje shorti e paanshme e transparente, pasi nga ana e KVO-së ishin parapërgatitur 4 zarfa të bardhë me mbishkrimin në format kompjuterik në secilin prej tyre numrat përkatës “1, 2, 3 dhe 4”, ku respektivisht secila prej tyre brenda kishte një “fitues” dhe tre “humbës”. Numrat e vendosur mbi të katërt zarfat ishin numra të mëdha me shkrim në Ëord + 300, pra me një madhësi lehtësisht të dallueshme nga cilido. Për pretendimet tona, do të paraqesim më poshtë dhe argumentimin juridik se përse shorti i hedhur më datë 10.02.2025, për prokurimin me Nr. REF-26458-10-25-2024 me objekt “Supervizim punimesh për objektin: ndërtim i sistemit të kanalizimeve të njësisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, me fond limit 8 028 361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, shoqëria Rajonale ujësjellës Kanalizime Pogradec duhet të anulohet.

Prokurimi publik është një nga mekanizmat kryesorë në menaxhimin e fondeve publike dhe duhet të udhëhiqet nga parime të qarta që garantojnë konkurrencën e ndershme dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike. Ndër parimet kryesore të cilat duhet të udhëheqin një procedurë prokurimi ndër të cilat dhe shpeshherë shkelen janë transparenca, trajtimi i barabartë dhe integriteti e paanshmëria, ashtu sic dhe në rastin konkret ka ndodhur. Ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Për shortin e datës 10.02.2025, në procedurën e prokurimit “procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime”, me REF-26458-10-25-2024, me objekt “Supervizim punimesh për objektin ndërtim i sistemit të kanalizimeve të njësisë administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, dhe fond limit 8.028.361,587 leke pa tvsh, të Autoritetit Kontraktor shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec, sic dhe kemi cilësuar në parashtrimet e rrethanave dhe fakteve, kemi arritur në përfundimin se janë cënuar parimet bazë të prokurimit publik;

Duke qenë se zarafat ishin të emërtuara me numrat “1, 2, 3 dhe 4” në mënyrë lehtësisht të dallueshme dhe identifikuese, ekziston mundësia që subjekti i përzgjedhur i pari në short të ketë qenë në dijeni të përmbajtjes së zarfit fitues, duke cënuar kështu parimin e transparencës.

Përdorimi i numrave dukshëm mbi zarfa krijon një avantazh të padrejtë për subjektin e përzgjedhur të parin në listën e sistemit SPE të AK-së, duke çënuar kështu parimin e trajtimit të barabartë.

Mënyra e organizimit të shortit krijon dyshime mbi objektivitetin dhe paanshmërisë së KVO-së dhe rrit ndjeshëm mundësinë e manipulimit të procesit, duke çënuar kështu parimin e integritetit dhe paanshmërisë.

Ligjvënësi ka përfshirë në kuadër të legjislacionit të prokurimit publik një listë të parimeve themelore, të cilat përbëjnë bazën ligjore dhe orientuese për realizimin e procedurave të prokurimit publik. Këto parime shërbejnë si udhëzues për Autoritetin Kontraktor (AK) dhe për operatorët ekonomikë (OE) në vijimësinë e procesit të prokurimit, duke garantuar se të gjitha fazat e procedurës do të realizohen në përputhje me rregullat e paracaktuara dhe në respekt të parimeve të barazisë, transparencës, paanshmërisë dhe konkurrencës së ndershme. Ky kuadër parimesh synon të sigurojë ligjshmërinë dhe efikasitetin e procedurës, duke mbrojtur interesat e palëve të përfshira dhe garantuar përdorimin e mjetave publike në mënyrë të drejtë dhe transparente.

Parimi i transparencës në prokurimin publik kërkon që të gjitha fazat e procedurës të jenë të qarta, të dokumentuara dhe të aksesueshme për publikun, duke garantuar kështu një proces të drejtë dhe të verifikueshëm. Ky parim synon parandalimin e çdo lloj manipulimi dhe forcimin e besimit të publikut tek institucionet shtetërore. Në procedurën konkrete, ky parim është çënuar si pasojë e zhvillimit të shortit në mënyrë të parregullt, duke krijuar dyshime të arsyeshme mbi ndershmërinë dhe ligjshmërinë e këtij veprimi. Mënyra në të cilën është organizuar shorti krijon premisa për ndërhyrje të paautorizuara apo manipulime, duke sjellë si pasojë cenimin e rëndë të transparencës dhe integritetit të procesit të prokurimit publik.

Vendosja e numrave dukshëm mbi zarf në shortin e zhvilluar më datë 10.02.2025, krijon hapësira që operatorët ekonomikë të dinë paraprakisht se cili zarf është fitues, duke e bërë procesin të manipulueshëm. Shkelja e këtij parimi nga AK bën që operatorët të ndihen të dekurajuar nga një sistem përzgjedhje të padrejtë duke bërë kështu publikun (të gjithë operatorët aplikues) të humasë besimi tek institucionet shtetërore.

Një tjetër parim i shkelur në këtë procedurë nga Autoriteti Kontraktor (AK) është parimi i trajtimit të barabartë, i cili është një nga parimet themelore që rregullojnë procedurat e prokurimit publik. Ky parim kërkon që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi të barabarta për të konkurruar, pa asnjë diskriminim apo favorizim të paligjshëm. Po ashtu, vlerësimi i ofertave duhet të bëhet mbi bazën e kriterëve objektive dhe të paracaktuara, që sigurojnë një proces të drejtë, të paanshëm dhe të transparencës. Shkelja e këtij parimi në këtë procedurë ka rezultuar në një proces të deformuar, ku janë krijuar kushte të pabarabarta për operatorët ekonomikë pjesëmarrës gjatë hedhjes së shortit.

Në rastin konkret objekt ankese, fakti që një operator ekonomik është renditur i pari në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) të Autoritetit Kontraktor dhe ka pasur mundësinë të zgjedhë i

pari zarfin, ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatet e shortimit, duke krijuar një pabarazi të pajustificuar midis operatorëve pjesëmarrës. Një veprim i tillë përbën shkelje të hapur të parimit të trajtimit të barabartë, pasi operatorëve të tjerë u është mohuar mundësia reale për të konkurruar në kushte të barabarta, duke iu krijuar një disavantazh të padrejtë dhe duke cenuar integritetin e procedurës, pa një procedurë konkurimi të ndershme për përzgjedhjen e operatorit që do të zgjidhte zarfin i pari.

Shorti në vetvete duhet të përfaqësojë një mekanizëm tërësisht të rastësishëm, ku asnjë pjesëmarrës nuk duhet të ketë përparësi të padrejtë ndaj të tjerëve. Megjithatë, në këtë rast, mënyra e zhvillimit të tij nga Autoriteti Kontraktor ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatet e përzgjedhjes, duke deformuar parimin e rastësisë dhe duke e bërë procesin jo transparent, diskriminues dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik. Për rrjedhojë, veprimet e Autoritetit Kontraktor bien ndesh me kuadrin ligjor në fuqi dhe krijojnë bazën për konstatimin e paligjshmërisë së procedurës së ndjekur.

Parimi i integritetit dhe paanshmërisë nënkupton që prokurimi publik duhet të zhvillohet pa ndikime të padrejta, pa konflikt interesi dhe pa favorizime të qëllimshme. OE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k., ngre dyshime të arsyeshme mbi paracaktimin e fituesit që në fillim të procesit, duke qënë përpara një shorti të manipuluar, kjo pasi për ç’arsye duhej të shënoheshin numra të mëdha me shkrim të zi, me madhësi shkrimi mbi 300 përbri zarfit.

Fakti që operatori ekonomik i renditur i pari në listën e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) ka pasur mundësinë të zgjedhë zarfin me përmbajtjen “fitues”, shton dyshimet e arsyeshme se fituesi mund të ketë qënë i paracaktuar që në fillim të procedurës. Lista e renditjes së operatorëve ekonomikë, e vendosur në dispozicion nga Komisioni i vlerësimit të Ofertave (KVO), nuk ka qënë transparente dhe e rastësishme, duke krijuar një hapësirë për abuzime. Gjithashtu, përdorimi i numrave të dukshëm për dallimin e zarfave ka krijuar mundësinë për manipulimin e zgjedhjes nga operatori i favorizuar, cka përbën një shkelje të rëndë të parimeve të transparencës dhe paanshmërisë, duke cenuar integritetin e procedurës së prokurimit.

Për sa më sipër, duke qënë se ne mendojmë që procedura e hedhjes së shortit është e padrejtë dhe jotransparente, kërkojmë:

- 1- Pranimin e ankesës së OE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k;
- 2- Pezullimin e procedurës së prokurimit si të paligjshme për shkak të shkeljeve që janë bërë nga Autoriteti Kontraktor;
- 3- Të shpallë të pavlefshëm shortin e zhvilluar më datë 10.02.2025, duke qënë se është cënuar rëndë parimi i transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë;
- 4- Të shfuqizojë vendimit e Komisionit të vlerësimit të Ofertave si të pabazuar në ligj për shpalljen fitues të Operatorit Ekonomik “HTS Company” sh.p.k.
- 5- Të shqyrtojë dhe të marrë masa ndaj KVO-së nëse konstatohet se ka pasur shkelje procedurale në mënyrën e hedhjes së shortit apo veprime të qëllimshme për favorizimin e subjektit fitues;

6- Të shpallë fitues OE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k.

II.18. Me shkresën nr. 13/20 prot, datë 18.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 455/2 prot datë 18.02.2025 (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), me objekt: “Vendimi për Shqyrtim Ankesë” autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës si dhe procesverbalin e hedhjes së shortit nr. 126 prot, datë 10.02.2025. Nga verifikimi aktit të trajtimit të ankesës nr. 13/20 prot, datë 18.02.2025, rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.19. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK, mbi kundërshtimin e hedhjes së shortit të datës 10.02.2025 për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Shorti i mbajtur më datë 10.02.2025, pranë AK është një short në shkelje të rregullave të prokurimit publik pasi; Nga ana e AK është vendosur që zgjedhja të bëhet nga operatorët sipas renditjes së gjeneruar në Sistemin e SPE të Autoritetit, ndërkohë kjo nuk është e drejtë. Pse duhet të përzgjidhet kjo renditje kur në renditjen e konsatuar në SPE-në e Operatorit Ekonomik “Gjeokonsult & Co” sh.p.k., kjo renditje rezulton e ndryshme nga ajo e paraqitur nga AK. Nga ana e Autoritetit, nuk është zbatuar një procedurë hedhje shorti e paanshme e transparente, pasi nga ana e KVO-së ishin parapërgatitur 4 zarfa të bardhë me mbishkrimin në format kompjuterik në secilin prej tyre numrat përkatës “1, 2, 3 dhe 4”, ku respektivisht secila prej tyre brenda kishte një “fitues” dhe tre “humbës”. Numrat e vendosur mbi të katërt zarfat ishin numra të mëdha me shkrim në Ëord + 300, pra me një madhësi lehtësisht të dallueshme nga cilido. Për pretendimet tona, do të paraqesim më poshtë dhe argumentimin juridik se përse shorti i hedhur më datë 10.02.2025, për prokurimin me Nr. REF-26458-10-25-2024 me objekt “Supervizim punimesh për objektin: ndërtim i sistemit të kanalizimeve të njësisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, me fond limit 8 028 361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, shoqëria Rajonale ujësjellës Kanalizime Pogradec duhet të anulohet” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

II.1.1. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike konkretisht rubrikës kërkesa për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi rezulton se autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik të kualifikuar me vlerë ofertë të barabartë si më poshtë vijon:

Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime sha Pogradec , mbeshetur ne VKM nr 285/2021 “Per miratimin e rregullave per prokurimin publik” neni 82 pika 6 per proceduren e prokurimit me objekt “Supervizion punimesh per objektin “Ndertimi i sistemit te kanalizimeve te njesise administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, Procedure e hapur e thjeshtuar – sherbime, me fondi limit 8.028.361,587 (tetë million e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH vendosi te perzgjedhe fituesin e procedures nepermjet procesit te hedhjes se shortit , per aresye se operatoret ekonomike pjesemares kane ofertuar me vlere te njejte.

Shorti do te zhvillohet prane zyrave qendrore te Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec , me adrese “Rruga e Gurrasit “Bucimas Pogradec, ne date 10.02.2025 ora 11:00.

III.1.2. Në datën 10.02.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar shortin, pjesëmarrës në short kanë qënë operatorët ekonomikë si vijon:

1. BOE “HTS Company” shpk & “HE & SK 11” shpk	7.024.816,39 I kualifikuar
2. BOE “Zetakonsult” SHPK & “Zenit & Co” SHPK	7.024.816,39 I kualifikuar
3. “Gjeokonsult & Co” SHPK	7 024 816,39 I kualifikuar

III.1.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se fitues nga shorti i datës 10.02.2025, rezulton bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “HTS Company” SHPK & “HE & SK 11” SHPK.

III.1.4. Në datën 18.02.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ku është shpallur fitues BOE “HTS Company” SHPK & “HE & SK 11” SHPK.

III.1.5. Në datën 17.02.2025, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2024/5054 dhe me nr. 455/2025 prot, datë 17.02.2025, e operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-26458-10-25-2024, me objekt “Supervizion punimesh per objektin “Ndertim i sistemit te Kanalizimeve Njesise Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec” me fond limit: 8.028.361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles Kanalizime sha Rajoni Pogradec. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me hedhjes e shortit të datës 10.02.2025.

III.1.6. Me shkresën nr. 13/20 prot, datë 18.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 455/2 prot datë 18.02.2025 (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), me objekt: “*Vendimi për Shqyrtim Ankesë*” autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës si dhe procesverbalin e hedhjes së shortit nr. 126 prot, datë 10.02.2025. Nga verifikimi aktit të trajtimit të ankesës nr. 13/20 prot, datë 18.02.2025, rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës.

III.1.7. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se në datën 17.02.2025, datë në të cilën operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor nuk ka publikuar as njoftimin e fituesit, as njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

III.1.8. Neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

III.1.9. Neni 111, pika 1, e Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikon se: “*1. “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”.*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: “*1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “*Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor*” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se: “*1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

III.1.10. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult & Co” SHPK, ka dorëzuar në datën 17.02.2024, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, ankesën me nr. A/2024/5054 dhe me nr. 455/2025 prot, datë 17.02.2025. Ndërkohë nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor në këtë datë, pra 17.02.2024, nuk është publikuar as njoftim - fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesin më datë 18.02.2025.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*, pasi në datën 17.02.2025 (data që operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën), nuk ishte publikuar as njoftim fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, më datë 17.02.2025, afati i paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nuk kishte filluar ende, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, apo njoftimi i anulimit të procedurës, që do të thotë se operatorit ekonomik ankimues nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 17.02.2025, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

III.1.11. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të

drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Gjeokonsult & Co” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-26458-10-25-2024, me objekt “Supervizion punimesh per objektin “Nderitim i sistemit te Kanalizimeve Njesise Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec” me fond limit: 8.028.361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles Kanalizime sha Rajoni Pogradec.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiovent Zguro

